



Nenad Mitrović deri më tani ka qenë pesë herë deputet popullor. Fillimisht u bë deputet në legjislaturën e gjashtë, nga viti 2004 deri në vitin 2007. Pas një pauze prej disa legjislaturave, ai u rizgjedh deputet në legjislaturën e dhjetë, në vitin 2014 dhe më pas në ato dy të ardhshme parlamentare, kështu që në pozitën e deputetit popullor është nga viti 2014 e deri më sot.

Në legjislaturën e 11-të ka qenë zëvendës anëtar i Komisionit për Mbrojtje dhe Punë të Brendshme, Komisionit për Diasporë dhe Serbët në Rajon dhe Komisionit për Kosovë e Metohi.

Në legjislaturën e 12-të ishte anëtar i Komisionit për Kosovë e Metohi dhe zëvendës anëtar i Komisionit për Mbrojtje dhe Punë të Brendshme dhe Komisionit për Kontrollin e Shërbimeve të Sigurisë.

Gjatë legjislaturës së 12-të, ai kaloi 440 orë në seancat e rregullta parlamentare.

Në legjislaturën e 13-të u zgjedh deputet si i 128-ti në listë “ALEKSANDAR VUČIĆ - Së bashku mund të bëjmë gjithçka”, i cili mandat u konfirmua më 26.10.2022.

Në legjislaturën e 13-të është pjesë e grupit parlamentar “ALEKSANDAR VUČIĆ - Së bashku mund të bëjmë gjithçka”. Është anëtar i Komisionit për Çështje Kushtetuese dhe Legjislacion, si dhe zëvendës anëtar i Komisionit për Punë, Çështje Sociale, Përfshirje Sociale dhe Ulje të Varfërisë dhe Komisionit për Çështje Administrativo-Buxhetare dhe Mandatoro-Imunitetare.

Është i lindur në vitin 1973. Jeton në Bujanoc. Me profesion është ekonomist i diplomuar.

Është këshilltar i Kuvendit të Komunës së Bujanocit që nga viti 2002 dhe deri më tani.

Karrierën e tij politike e filloi në Partinë Radikale Serbe, në të cilën ishte anëtar deri në vitin 2008, kur kaloi në Partinë Përparimtare Serbe.

Është kryetar i Këshillit Komunal të Partisë Përparimtare Serbe.

ARSIMIMI:

Ekonomist i diplomuar

EKSPERIENCA NË PUNË :

1997-1998 AD "Malina" Vrajë – referent komercialist;
1999-2001 Ministria e Tregtisë - Inspektor republikan i tregësisë;
2002-2002 DP “Jugokop” Bujnoc – Udhëheqës i tregtisë me pakicë;
2004-2007 Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë – deputet popullor;
2009-2010 DP "Vrelo Prohorovo" Bujanoc - Drejtor;
2013-2014 Spitali Special Rehabilitues “Banja e Bujanocit” – bashkëpunëtor marketingu;
2014-2016 Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë – Deputet popullor;
2016-2020 Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë – Deputet popullor;
2020-2022 Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë – Deputet popullor;
2022-2023 Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë – Deputet popullor;
2021-2023 Përfaqësues i degës për hotelieri dhe turizëm në Banjën e Bujanocës;
2013-2014 Ndihmës i kryetarit të Komunës së Bujanocit për zhvillim ekonomik lokal;
2002-2006 Këshilltar në Kuvendin lokal të Komunës së Bujanocit, kryetar i grupit të këshilltarëve;
2006-2008 Këshilltar në Kuvendin lokal të Komunës së Bujanocit, kryetar i grupit të këshilltarëve;
2008-2009 Këshilltar në Kuvendin lokal të Komunës së Bujanocit, kryetar i grupit të këshilltarëve;
2012-2016 Këshilltar në Kuvendin lokal të Komunës së Bujanocit, kryetar i grupit të këshilltarëve;
2016-2020 Këshilltar në Kuvendin lokal të Komunës së Bujanocit, kryetar i grupit të këshilltarëve;
2020- Këshilltar në kuvendin lokal të komunës së Bujanocit, kryetar i grupit të këshilltarëve;

GJUHËT E HUAJA:

Gjuha ruse;

AFTËSITË TJERA:

- Njohuri në punën në kompjuter
- Leje të vozitjes në kategorinë B, C dhe E, vozitës aktiv.